



**KOLEGJI RIINVEST  
STATUTI I KOLEGJIT RIINVEST SH.A**

16 NËNTOR 2017

Në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare në Republikën e Kosovës (Ligji 02/L-123), përfshirë ndryshimet e tij të miratuara në Ligjin 04/L-006, Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Ligji 04/L-037), si dhe në pajtim me dispozitat dhe autorizimet e veta staturore për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Shoqërisë, Kuvendi i Aksionarëve të Bartësit Privat të Arsimit të Lartë Kolegji Riinvest sh.a. më 07 nëntor 2017 vendosi që të nxjerr Statutin e ri të Kolegjit Riinvest sh.a..

## **THEMELIMI, EMËRTIMI DHE FORMA LIGJORE E ORGANIZIMIT TË SHOQËRISË**

### **Neni 1**

#### **Forma e shoqërisë**

Kolegji Riinvest është shoqëri aksionare (sh.a.), e cila organizohet dhe funksionon në përputhje me Ligjin mbi Shoqëritë Tregtare, Ligji Nr. 02/L-123/2007, dhe Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Ligji Nr. 04/L-037/2011, si dhe me të gjitha aktet tjera nënligjore që mund të rrjedhin nga këto ligje e që rregullojnë veprimtarinë e bartësve të arsimit të lartë dhe shoqërive aksionare në Republikën e Kosovës.

### **Neni 2**

#### **Emërtimi i shoqërisë**

1. Emri i plotë i shoqërisë është: Kolegji RIINVEST Sh.A. Në këtë Statut, si dhe në aktet tjera normative të miratuara nga organet e Kolegjit Riinvest Sh.A., atij mund t'i referohet në formë të shkurtuar si Shoqëria / Kolegji / Kolegji Riinvest, dhe Riinvest.
2. Termet e dhëna për cilëndo gjini në këtë Statut nënkuptojnë edhe gjininë tjetër dhe nuk paragjykojnë gjininë e bartësit të cilitdo post.

### **Neni 3**

#### **Selia e shoqërisë**

- 3.1 Selia e shoqërisë është në Prishtinë, Rr. "Lidhja e Prizrenit", nr. 56, në Prishtinë.
- 3.2 Shoqëria mund të krijojë njësi akademike dhe kërkimore brenda vendit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe jashtë vendit në përputhje me legjislacionin e atij vendi, pa cenuar legjislacionin e Kosovës.

### **Neni 4**

#### **Logoja dhe vula**

- 4.1 Kolegji Riinvest e ka vulën me këtë përmbajtje: Kolegji Riinvest (shqip) dhe Riinvest College (anglisht).
- 4.2 Kolegji Riinvest e ka logon vet, të cilën e miraton me shumicë votash Bordi Drejtues, dhe e cila duhet të jetë e pranishme në të gjitha korrespondencat zyrtare të Kolegjit.

## **Neni 5**

### **Kapitali themelor**

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 751.973.00€. Ai është i ndarë në 751.973 aksione të zakonshme me vlere nominale 1 € secili, të numëruara nga numri 1 (një) deri në 751.973 (shtatëqindpesëdhjetënjëmijë e nëntëqindeshtatëdhjetë) përfshirë edhe numrin e fundit.

5.2 Kontribues në kapitalin themeltar dhe pronarë të aksioneve të shoqërisë janë:

1. **Valton Bilalli**, me vendbanim në Marigona Residence, rr. Oklahoma nr. 1, me numër personal 1004107060, ka kontribuar në shumën e përgjithshme të kapitalit themeltar me €309.602,85 dhe është pronar i 41.17% të aksioneve të shoqërisë.

2. **Rasim Mrlaku**, me vendbanim në Prishtinë, Lidhja e Prizrenit 79, me numër personal 1004108341, ka kontribuar në shumën e përgjithshme të kapitalit themeltar me €303.264.20 dhe është pronar i 40.32% të aksioneve të shoqërisë;

3. **Lutfi Zharku**, me adresë banimi në Kaçanik, Rr. Remzi Zharku, pn. me numër personal 1012499988, ka kontribuar në shumën e përgjithshme të kapitalit themeltar me €47.464,69 dhe është pronar i 6.31% të aksioneve të shoqërisë;

4. **Hazir Gashi**, me vendbanim në Ferizaj, adresa: Rr. Brahim Ademi nr 38, me numër personal 1003439581, ka kontribuar në shumën e përgjithshme të kapitalit themeltar me €30.078,92 dhe është pronar i 4% të aksioneve të shoqërisë;

5. **Gent Beqiri**, me vendbanim në Prishtinë, rr. Lekë Dukagjini, nr. SU 6/2, LAM L/14 me numër personal 1030721477, ka kontribuar në kapitalin themeltar me €9.601,25 dhe është pronar i 1,28% të aksioneve të shoqërisë;

6. **Alban Hashani** me vendbanim në Prishtinë, rr. Rexhep Luci, nr. 16/3 me numër personal 1014726787, ka kontribuar në shumën e përgjithshme të kapitalit themeltar me €7.444.59 dhe është pronar i 0,99% të aksioneve të shoqërisë;

7. **Driton Statovci**, me vendbanim në Batllavë, Komuna e Podujevës me numër personal 1030648826, ka kontribuar në shumën e përgjithshme të kapitalit themeltar me €6.000,78 dhe është pronar i 0.8% të aksioneve të shoqërisë;

8. **Lule Ahmedi**, me vendbanim në Prishtinë, Lidhja e Prizrenit, Kati III, nr. 13 me numër personal 1500572660, ka kontribuar në shumën e përgjithshme të kapitalit themeltar me €6.000,78 dhe është pronar i 0.8% të aksioneve të shoqërisë;

9. **Yll Haxhimusa**, me vendbanim në Ferizaj, Rruga Ismail Qemali, nr. 25, me numër personal 1003258404 ka kontribuar në shumën e përgjithshme të kapitalit themeltar me €6.000,78 dhe është pronar i 0.8% të aksioneve të shoqërisë;

10. **Nysret Musliu**, me vendbanim në fshatin Lebanë, komuna e Prishtinës, me numër personal 1010157648 ka kontribuar në shumën e përgjithshme të kapitalit themeltar me €4.978.53 dhe është pronar i 0.66% të aksioneve të shoqërisë;

11. **Arian Shala**, me vendbanim në Prishtinë, Rr. Hoxhë Kadri Prishtina nr. 13/a, me numër personal 1030822281 ka kontribuar në shumën e përgjithshme të kapitalit themeltar me €6.000,78 dhe është pronar i 0.8% të aksioneve të shoqërisë;

12. **Idriz Smaili**, me vendbanim në Prishtinë, rr. Vëllezërit Fazliu p.n., me numër personal 1233034416 ka kontribuar në shumën e përgjithshme të kapitalit themeltar me €4.987.53 dhe është pronar i 0.66% të aksioneve të shoqërisë;

13. **Lumir Abdixhiku**, me vendbanim në Prishtinë, rr Shpëtim Robaj nr. 247 me numër personal 1000974176, ka kontribuar në shumën e përgjithshme të kapitalit themeltar me €3.722,29 dhe është pronar i 0,5% të aksioneve të shoqërisë;

14. **Fadil Aliu** me vendbanim në Prishtinë. Rr. Ismet Krasniqi p.n., me numër personal 1030931374, ka kontribuar në shumën e përgjithshme të kapitalit themeltar me €3.722,29 dhe është pronar i 0,5% të aksioneve të shoqërisë;

15. **Artane Rizvanolli** me vendbanim në Prishtinë, rr. Bekim Berisha nr. 11 me numër personal 1004147002, ka kontribuar në shumën e përgjithshme të kapitalit themeltar me €3.093.77 dhe është pronar i 0,41% të aksioneve të shoqërisë;

## **Neni 6** **Personi i Autorizuar**

Person i autorizuar për çështje administrative dhe nënshkrim në emër të Kolegjit për nevoja të procedurave për ndryshime dhe plotësime të Statutit në Agjencionin për Regjistrim të Bizneseve është Kryetari i Kuvendit të Aksionarëve, z. Rasim Mrlaku, i cili për këtë qëllim autorizimin mund ta bartë edhe tek një anëtar tjetër i Bordit të Drejtorëve, Sekretari i Kolegjit apo zyrtar i lartë i Kolegjit, me vendim me shkrim për këtë çështje.

## **VIZIONI, MISIONI, QËLLIMET DHE VEPRIMTARIA E KOLEGJIT**

### **Neni 7** **Misioni**

Misioni i Kolegjit Riinvest është që të ofrojë studime dhe kërkime të cilësisë së lartë për të siguruar ekspertë në dobi të nevojave zhvillimore të Kosovës, me kapacitete për të konkurruar edhe në nivel global.

### **Neni 8** **Vizioni**

Vizioni i Kolegjit Riinvest është të bëhet kolegji model në rajon, që ofron studime të standardeve të larta ndërkombëtare në gjuhën shqipe dhe angleze në ekonomi, biznes, teknologji informative e qeverisje; që kultivon kreativitet dhe ndërmarrësi dhe siguron normë të lartë punësimi për të diplomuarit e vet; me personel dhe studentë që përfaqësojnë mjedis të llojllojshëm kulturor dhe me jetë sportive të studentëve të mundësuar nga infrastruktura e zhvilluar në kampus që u përgjigjet nevojave komplekse të studimeve moderne. Institucioni ynë do të jetë dalluar dhe i njohur si qendër e fortë për kërkime në dobi të zhvillimit ekonomik dhe social të shoqërisë.

### **Neni 9** **Qëllimet**

9.1 Kolegji Riinvest është themeluar për t'i ndjekur këto qëllime:

- Zhvillimin e aktiviteteve të arsimit të lartë;
- Realizimin e aktiviteteve kërkimore dhe zhvillimore;
- Sigurimin e arsimit të krahasueshëm dhe konkurrent me arsimin e lartë të vendeve evropiane;
- Ofrimin e arsimit të konceptuar sipas standardeve bashkëkohore evropiane, sipas objektivave të Procesit të Bolonjës;
- Promovimin e edukimit për biznes/menaxhment bashkëkohor dhe bartjen e “Know-How” për menaxhmentin e zhvillimit ekonomik.

9.2 Në arritjen e qëllimeve të veta, Kolegji do të sigurojë liri akademike për të gjithë mësime të mësimdhënësit dhe studentët e vet, të cilëve u garanton të drejtën për të paraqitur ide dhe opinione të debatueshme pa rrezikuar humbjen e vendit të punës apo privilegjet që ata i gëzojnë.

9.3 Në arritje e qëllimeve sipas këtij neni, si dhe në tërë veprimtarinë e vet, Kolegji do t'u sigurojë studentëve dhe mësime të mësimdhënësve mundësi për këshillim mes tyre dhe menaxhmentit lidhur me të gjitha çështjet akademike.

## **Neni 10** **Veprimtaria**

10.1 Objekt primar i veprimtarisë së Kolegjit Riinvest do të jetë veprimtaria e zhvilluar në kodet ekonomike të mëposhtme:

- 8542 - Arsimi i lartë;
- 8041 - Arsimi pas i mesëm por jo i lartë;
- 8559 - Arsimi tjetër p.k.t;
- 8560 - Aktivitete mbështetëse arsimore;
- 8230 - Organizim i konferencave dhe panairëve afariste
- 7022 - Aktivitete të këshillimit për biznes dhe këshillat e tjera për menaxhim
- 7320 - Hulumtimi i tregut dhe matja e opinionit publik;
- 7490 - Aktivitete tjera profesionale, shkencore dhe teknike p.k.t;
- 6311- Përpunimi i të dhënave, hostimi i informacionit dhe aktivitetet e lidhura me to;
- 6209 - Teknologjia tjetër informative dhe aktivitetet shërbyese kompjuterike;
- 6202 - Aktivitetet e këshillimeve kompjuterike;
- 6201 - Aktivitete të programit kompjuterik;
- 5829 - Publikimi i softuerëve të tjerë;
- 5821 - Publikimi i lojrave kompjuterike;
- 5819 - Aktivitete tjera botuese;
- 5814 - Publikimi i revistave periodike;
- 5813 - Publikimi i gazetave;
- 5811 - Publikimi i librave;

10.2 Kolegji ruan të drejtën e zgjerimit të veprimtarisë së vet edhe në fusha tjera të ndërlidhura.

## **STRUKTURA QEVERISËSE E KOLEGJIT**

### **Neni 11** **Organet e Kolegjit**

11.1 Organet udhëheqëse të Kolegjit janë:

- a. Kuvendi i Aksionarëve,
- b. Bordi Drejtues,
- c. Rektori, dhe
- d. Këshilli Akademik.

11.2 Struktura organizative e organeve udhëheqëse të Kolegjit është dhënë në Shtojcën 1 të këtij Statuti.

## **Neni 12**

### **Kuvendi i Aksionarëve**

12.1 Kuvendi i Aksionarëve (në tekstin e mëtejme Kuvendi) është organi më i lartë qeverisës i Kolegjit, i cili përbëhet prej të gjithë aksionarëve të regjistruar në Listën e Aksionarëve, e cila mbahet nga Kolegji dhe e cila përkon me listën e aksionarëve të listuar në nenin 5 të këtij Statuti. Kuvendi i Aksionarëve zgjedhë Kryetarin e Kuvendit, i cili njëkohësisht shërben si Kryetar i Bordit Drejtues.

12.2 Të drejtat e votimit në Kuvend përkojnë me të drejtat pronësore të Aksionarëve në Shoqëri, ndërsa vendimet në Kuvend, përveç në rastet e përcaktuara shprehimisht ndryshe me këtë Statut dhe me Rregulloren e Punës së Kuvendit të Aksionarëve, merren me shumicë të thjeshtë (50.01%) të të gjitha votave të pranishme në Kuvendin e Aksionarëve në të cilin është konstatuar kuorumi, në pajtim me nenin 13.2 të këtij Statuti.

12.3 Kuvendi është përgjegjës për miratimin dhe ndryshimin e Statutit dhe Rregullores së Punës së Kuvendit të Aksionarëve të Kolegjit, si dhe për miratimin e dokumenteve strategjike dhe politikave zhvillimore të Kolegjit dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë financiare dhe politikave menaxhuese të organeve tjera të Kolegjit.

12.4 Kuvendi emëron Bordin e Drejtorëve, i cili është përgjegjës për qeverisjen e Kolegjit mes dy Kuvendeve, si dhe për zbatimin e dokumenteve strategjike dhe politikave zhvillimore të Kolegjit.

12.5 Për çështjet e listuara në vijim vendos ekskluzivisht Kuvendi i Kolegjit:

- (a) ndryshimin dhe plotësimin e Statutit dhe Rregullores së Punës së Kuvendit të Aksionarëve të Kolegjit;
- (b) rritjen apo zvogëlimin e kapitalit themelor të shoqërisë;
- (c) konsolidimin e aksioneve të emetuara dhe të pashlyera;
- (d) ndarjen e aksioneve të emetuara ose të pashlyera apo emetimin e aksioneve shtesë;
- (e) përbërjen e Bordit të Drejtorëve;
- (f) likuidimin e shoqërisë;
- (g) kërkimin e mbrojtjes në ligjet e falimentimit apo paaftësisë paguese; dhe
- (h) caktimin e auditorit të jashtëm të veprimtarisë financiare të shoqërisë.

12.6 Të gjitha vendimet nga paragrafi 5 i këtij neni merren me shumicë prej 2/3 (dy të tretave) të të gjitha aksioneve të emetuara dhe shtesë.

12.7 Sekretari i Kolegjit do të shërbejë edhe si Sekretar i Kuvendit të Aksionarëve të Kolegjit dhe do të mbajë regjistrat e vendimeve dhe procesverbaleve të Kuvendit, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Kuvendit të Aksionarëve të Kolegjit.

## **Neni 13**

### **Mbledhjet e Kuvendit të Aksionarëve**

13.1 Kuvendi veprimtarinë e vet e zhvillon në Kuvende të Rregullta dhe të Jashtëzakonshme, të cilat organizohen në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, këtë Statut dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit të Aksionarëve, të cilën ai vet e miraton. Kuvendi i Rregullt i Kolegjit do të mbahet së paku një herë në vit, dhe jo më vonë se deri në fundin e muajit të tretë pas përfundimit të çdo viti kalendarik.

13.2 Kuorumi i Kuvendit të Aksionarëve konsiderohet se është plotësuar në çdo rast kur në mbledhjet e Kuvendit që janë thirrur në pajtim me dispozitat ligjore dhe të akteve të Shoqërisë janë të pranishëm pronarët ose personat e autorizuar të pronarëve të së paku 50.01% të aksioneve të Shoqërisë. Përrjashtimisht kësaj dispozite, në rastet kur në rendin e ditës së Kuvendit janë vendosur çështje për të cilat kërkohet vendimmarrje sipas nenit 12.5 të këtij Statuti, atëherë kuorumi në mbledhjet e Kuvendit të Aksionarëve konsiderohet se është arritur kur të pranishëm në Kuvend janë së paku 2/3 dy të tretat e të gjitha aksioneve të Shoqërisë.

13.3 Kuvendet e Jashtëzakonshme mund të mbahen në pajtim me procedurat e përcaktuara në ligj, këtë Statut dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit të Aksionarëve të Kolegjit, kurdo që shfaqet nevoja për thirrjen e tyre. Kuvendet e Jashtëzakonshme mund të thirren nga Bordi Drejtues, apo nga aksionarët që zotërojnë jo më pak se 1/3 (një të tretën) e aksioneve të Shoqërisë, të cilët kërkesën për mbajtjen e Kuvendit të Jashtëzakonshëm ia paraqesin Kryetarit të Kuvendit.

13.4 Procedurat e detajuara të thirrjes, mbajtjes dhe udhëheqjes së mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve do të përcaktohen në Rregulloren e Punës së Kuvendit të Aksionarëve të Kolegjit, e cila do të jetë dokument publik dhe do t'i vihet në dispozicion të gjithë aksionarëve të regjistruar të shoqërisë.

## **Neni 14**

### **Bordi Drejtues**

14.1 Bordi Drejtues i Kolegjit është organi më i lartë menaxhues që përbëhet nga gjashtë drejtorë të zgjedhur nga Kuvendi i Aksionarëve të Kolegjit për të menaxhuar me Kolegjin mes dy Kuvendeve. Bordi Drejtues ka mandat trevjeçar, me mundësi rizgjedhjeje. Në rast se për çfarëdo arsye ndonjë pozitë në Bordin e Drejtorëve mbetet vakant, Bordi i Drejtorëve mund të vendosë me votat e të gjithë anëtarëve të mbetur të Bordit për zëvendësimin e asaj pozite nga një drejtor i ri, i cili do të mbajë pozitën deri në fund të mandatit fillestar të Bordit Drejtues, ose deri në Kuvendin e parë të Rregullt të Aksionarëve të Kolegjit kur ky i fundit do të vendosë për zëvendësimin e tij. Në rast se për çfarëdo arsye Bordi Drejtues nuk ka kuorum për vendimmarrje, Drejtorët ose Drejtori i Mbetur do të ketë të kompetencë të thërrasë Kuvendin e Aksionarëve me qëllim të plotësimit të vendeve të mbetura vakante në Bordin e Drejtorëve.

14.2 Kryetari i Kuvendit të Aksionarëve është me automatizëm anëtar i Bordit Drejtues dhe shërben si Kryetar i tij. Pesë anëtarë tjerë të Bordit Drejtues zgjedhen nga Kuvendi i Aksionarëve, në bazë të propozimeve të cilat mund të paraqiten nga të gjithë aksionarët që zotërojnë individualisht ose kumulativisht së paku dhjetë për qind të aksioneve të Shoqërisë. Procedura për zgjedhjen e Bordit të Drejtorëve do të përcaktohet në Rregulloren e Punës së Kuvendit të Aksionarëve të Kolegjit.

14.3 Anëtarë të Bordit Drejtues mund të jenë të gjithë personat të cilëve një pozitë e tillë nuk u ndalohet me ligjet e aplikueshme në Kosovë apo me këtë Statut dhe aktet normative të Kolegjit, dhe të cilët nuk janë në pozitë të konfliktit interesi gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre në Bordin e Drejtorëve.

14.4 Bordi Drejtues në takimin e vet të parë konstituiv në përbërjen e re, do të miratojë Rregulloren e Punës së Bordit Drejtues, e cila do të specifikojë procedurat për thirrjen e mbledhjeve, udhëheqjen e tyre, diskutimin dhe vendimmarrjen në Bordin Drejtues. Përveç në situatat kur me Rregulloren e Punës së Bordit Drejtues përcaktohet ndryshe, vendimet e Bordit Drejtues merren me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të tij.

14.5 Bordi Drejtues është përgjegjës për menaxhimin e të gjitha fushave dhe çështjeve të cilat nuk janë kompetencë ekskluzive e Kuvendit të Aksionarëve dhe për përcjelljen më të afërt të veprimtarisë së

Kolegjit. Për këtë qëllim, Bordi Drejtues do të mbajë mbledhje të rregullta jo më rrallë se një herë në muaj, si dhe mbledhje të jashtëzakonshme kurdo që për këtë shfaqet nevoja.

14.6 Bordi Drejtues është ekskluzivisht përgjegjës për miratimin e akteve në vijim:

- (a) Rregulloren për Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Diagramin Organizativ të Kolegjit,
- (b) Rregulloren Disiplinore dhe të Kodit të Etikës,
- (c) Rregulloren mbi Procedurat dhe Politikat e Kolegjit,
- (d) Planin e Biznesit të Kolegjit,
- (e) Programet Akadematike të Kolegjit,
- (f) Procedurat e Autorizimeve Financiare në Kolegj,
- (g) Rregulloren e Punës së Këshillit Akademik, dhe
- (h) Të gjitha aktet tjera normative që i konsideron të nevojshme për veprimtarinë e Kolegjit.

14.7 Bordi Drejtues është përgjegjës për zgjedhjen dhe emërimin e Rektorit të Kolegjit, Sekretarit të Kolegjit, si dhe për konfirmimin e zgjedhjes së drejtuesve të departamenteve të Kolegjit.

14.8 Bordi Drejtues merr vendime mbi afarizmin financiar dhe investimet në Kolegj, si dhe siguron koordinimin e punëve dhe veprimtarinë e njësisve të ndryshme të Kolegjit në përputhje me planet strategjike dhe afariste të Kolegjit. Bordi Drejtues është përgjegjës për marrjen e vendimeve për huamarrje ose nxjerrje të obligacioneve dhe instrumenteve tjera të konvertueshme të borxhit; masën e kompensimit të nëpunësve të Kolegjit; menaxhimin dhe administrimin e tepricave;

14.9 Bordi Drejtues autorizon nënshkrimin e marrëveshjeve dhe kontratave me vlerë më të lartë se 2500.00€, dhe mbikëqyrë dhe kontrollon realizimin e projekteve. Bordi Drejtues siguron implementimin e kontrollit financiar mbi librat dhe llogaritë e Kolegjit nga Auditori i Jashtëm i zgjedhur nga Kuvendi i Kolegjit, së paku një herë në vit, si dhe i siguron të gjithë aksionarëve, drejtorëve dhe udhëheqësve të lartë të Kolegjit qasje të papenguar në raportet e auditimit të përgatitura i njëjti.

14.10 Bordi Drejtues do t'i raportojë Kuvendit të Aksionarëve për veprimtarinë e vet së paku një herë në vit në Kuvendin e Rregullt të Aksionarëve, apo sado herë që një gjë e tillë i kërkohet shprehimisht në Kuvendet e Jashtëzakonshme të Aksionarëve.

14.11 Bordi Drejtues do të shqyrtojë dhe miratojë raportin vjetor të përgatitur nga Rektori i Kolegjit dhe udhëheqësit e departamenteve të tij, në të cilin do të detajohet veprimtaria financiare, programatike, akademike dhe e natyrave tjera, e në të cilin do të paraqiten të gjitha të dhënat dhe informatat që mund të kërkohen me Statut, akte tjera normative të Kolegjit apo me ligj. Bordi Drejtues do të pranojë dhe shqyrtojë edhe të gjitha raportet mujore dhe periodike të përgatitura nga Rektori i Kolegjit dhe udhëheqësit e departamenteve të tij, dhe mund të kërkojë që të pranishëm në mbledhjet e veta të jetë cilido punonjës i Kolegjit apo person tjetër i cili mund të ofrojë informata dhe raporte të rëndësishme për veprimtarinë e Kolegjit.

14.12 Bordi Drejtues mund të krijojë komisione dhe këshilla të cilët i ndihmojnë në kryerjen e veprimtarisë së vet sipas ligjit, këtij Statuti apo akteve tjera normative të Kolegjit. Trupat e tilla të krijuara nga Bordi Drejtues kanë karakter këshillëdhënës dhe ato nuk mund të ushtrojnë kompetencat e Bordit të Drejtorëve. Me rastin e konstituimit të çdo Bordi Drejtues të ri, i njëjti do të themelojë një Komitet Këshillëdhënës, i cili do t'i ndihmojë Bordit Drejtues në kryerjen e detyrave të veta. Bordi Drejtues do t'ia përcaktojë Komitetit Këshillëdhënës përbërjen, procedurat dhe planin e punës.



14.13 Anëtarët e Bordit Drejtues kanë detyrim të veprimit në mirëbesim ndaj Kolegjit. Ky detyrim përfshin detyrimin për të vepruar në mirëbesim dhe në përfitim të gjithë Kolegjit, të ushtrimit të kompetencave vetëm për qëllimet e duhura, detyrimin për të shqyrtuar në mënyrën e duhur çështjet për të cilat do të merret një vendim, detyrimin për të shmangur konfliktet aktuale ose potenciale të interesave të tij personale dhe atyre të Kolegjit, si dhe detyrimin për të ushtruar kujdes dhe aftësi në përmbushjen e funksioneve të tij.

14.14 Sekretari i Kolegjit shërben edhe si Sekretar i Bordit të Drejtorëve dhe është përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të vendimeve dhe akteve të miratuara nga Bordi i Drejtorëve, si dhe procesverbaleve të takimeve të tij.

## **Neni 15** **Rektori**

15.1 Rektori i Kolegjit zgjedhet nga Bordi Drejtues për një mandat trevjeçar, me mundësi rizgjedhjeje. Rektori duhet të jetë person me integritet të lartë dhe aftësi për ta realizuar me sukses menaxhimin ditor të Kolegjit dhe njësive të tij.

15.2 Rektori i Kolegjit është udhëheqës i të gjitha njësive akademike të Kolegjit, Kryetar i Këshillit Akademik të Kolegjit dhe shërben si kryeshef ekzekutiv i Kolegjit.

15.3 Rektori i Kolegjit raporton në çdo mbledhje të Bordit Drejtues për veprimtarinë dhe rrjedhën e punëve në Kolegj, si dhe ia paraqet edhe raportet e rregullta periodike me shkrim për veprimtarinë financiare, afariste dhe akademike të Kolegjit.

15.4 Rektori është përgjegjës për përfaqësimin e Kolegjit në Kosovë dhe jashtë vendit; menaxhimin e buxhetit të miratuar nga Kuvendi apo Bordi Drejtues; menaxhimin e bilancit të gjendjes dhe përcjelljen e rrjedhës së parasë; përmbushjen e planit të të hyrave; sigurimi i kryerjes së obligimeve financiare ndaj palëve të treta; propozimi i masave për rritjen e inkasimit; propozimi i planit strategjik dhe planit të biznesit dhe marrja e masave për realizimin e tij; raportimi para Kuvendit të Aksionarëve dhe Bordit të Drejtorëve; nënshkrimi i kontratave në emër të Kolegjit; i mbikëqyr të gjitha librat, raportet dhe certifikatat e kërkuara me ligj;

15.5 Rektori koordinon me Këshillin Akademik, në cilësinë e Kryetarit të tij, në përgatitjen e propozimit të planprogramit mësimor dhe shkencor të Kolegjit, si dhe propozimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të tij; propozon planprogramin mësimor të Kolegjit dhe programeve individuale; bashkëpunon ngushtë me udhëheqësit e departamenteve në zhvillimin e programeve akademike dhe në kuptim të bashkëpunimit ndërkombëtar. Rektori planifikon mbledhjet e Këshillit Akademik dhe propozon rendin e ditës për to.

15.6 Rektori bashkëpunon me organet tjera të Kolegjit në zhvillimin bashkëpunimeve dhe partneriteteve me institucione tjera në Kosovë dhe jashtë vendit. Rektori përfaqëson Kolegjin në bashkëpunim ndërkombëtar dhe para partnerëve tjerë në të gjitha çështjet akademike.

15.7 Rektori i kryen të gjitha përgjegjësitë tjera të parapara me ligj, këtë Statut apo aktet tjera normative të Kolegjit, përfshirë obligimet lidhur me nënshkrimin e diplomave dhe dokumenteve tjera zyrtare të Kolegjit.

## **Neni 16** **Këshilli Akademik**

16.1 Këshilli Akademik përbëhet nga Rektori i Kolegjit, i cili është edhe Kryetar i Këshillit Akademik dhe përfaqësues tjerë të zgjedhur apo të emëruar në bazë të pozitave udhëheqëse në strukturat akademike

të Kolegjit. Anëtarë të Këshillit Akademik të Kolegjit janë Udhëheqësit e Programeve Akademike të Kolegjit, përfaqësuesit e zgjedhur nga komiteteve programorë, përfaqësuesit e zgjedhur të administratës dhe përfaqësuesit e zgjedhur të studentëve. Mandati i anëtarëve të Këshillit Akademik është tri vjet dhe fillon ditën e parë të vitit akademik.

16.2 Këshilli Akademik mbledhet së paku dy herë brenda një semestri dhe shqyrton:

- Zhvillimin akademik si dhe modifikimin e programeve të studimeve,
- Raportet e komiteteve programore,
- Suksesin e studentëve,
- Raportin e Zyrës/Komisionit për sigurim të cilësisë,
- Rregulloret e zbatueshme, dhe
- Çështje tjera akademike.

16.3 Këshilli Akademik ka përgjegjësi për të vendosur për çështjet strategjike që lidhen me procesin e mësimdhënies dhe të studimeve dhe me kërkimet shkencore, si dhe është përgjegjës që:

- Të miratojë programet e studimeve të njësive akademike;
- Të përcaktojë kriteret për regjistrimin e studentëve të rinj;
- Të definojë standardet akademike për ligjërata dhe për sigurimin e cilësisë së studimeve;
- Të përcaktojë kriteret për emërimin e personelit akademik;
- Të vendosë mbi strukturën dhe përmbajtjen e programeve mësimore;
- Të përcaktojë përmbajtjen e të gjitha të dhënave akademike dhe dokumentacionit të kolegjit;
- Të vendosë mbi zgjedhjet, avancimet dhe dhënien e titujve akademikë;
- Të analizojë performancën e stafit akademik;
- Të koordinojë mekanizmat për cilësinë e studimeve në universitet;
- Të hartojë Strategjinë e zhvillimit dhe mbrojtjes së pronës intelektuale të Kolegjit.

16.4 Secili anëtar i Këshillit Akademik gëzon një votë, duke përfshirë edhe votën e Kryetarit, e cila mund të jetë vendimtare në rast të votimit të ndarë. Çdo herë kur takohet Këshilli Akademik, duhet të mbahet procesverbal për çështjet që diskutohen me identifikim të pikave të përshtatshme veprimi. Menjëherë pas takimit, duhet t'u shpërndahet draft procesverbali të pranishmëve për komente në saktësi dhe pasi të nënshkruhet nga Kryetari, veprimet duhet të pasohen me rezultate që raportohen në takimin e radhës. Një kopje e procesverbaleve të tilla me pika veprimi duhet të mbahet në dosje për qëllim auditimi. Këshilli Akademik i miraton programet e reja, rregulloret dhe udhëzuesit si edhe raportet e vlerësimit përmes këtyre komisioneve.

16.5 Këshilli Akademik vepron sipas Rregulloreve të Punës, e cila aprovohet nga Këshilli Akademik. Me këtë rregullore përcaktohen procedurat për thirrjen, udhëheqjen, mënyrën e vendosjes dhe çështjet e tjera organizative të mbledhjeve të Këshillit Akademik.

16.6 Këshilli Akademik i ka 3 komisione të përhershme – Komisionin për Sigurim të Cilësisë, Komisionin Disiplinor, Komisionin për Ankesa.

16.7 Komisioni për Sigurim të Cilësisë është përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e procedurave të vlerësimit në pajtim me Statutin dhe rregulloret e institucionit. Komisioni siguron zbatimin e standardeve ndërkombëtare dhe standardeve të Agjencisë për Akreditim të Kosovës si dhe i propozon Këshillit Akademik rekomandime përkatëse. Komisioni i miraton afatet për vlerësim, e miraton përbërjen e ekipeve të vlerësimit dhe nxit kulturën e cilësisë.

16.7.1 Në fillim të çdo viti akademik, komisioni në takimin e parë zgjedh Kryesuesin e komisionit. Kryesuesi i komisionit zgjidhet me shumicë votash të anëtarëve të komisionit. Detyra e Kryesuesit të komisionit është që të organizojë punën e komisionit.

16.7.2 Komisioni për sigurimin e cilësisë gjithsej ka tetë anëtarë: pesë anëtarë të zgjedhur - tre anëtarë të personelit mësimdhënës, një përfaqësues të studentëve dhe një përfaqësues nga administrata; dhe tre anëtarë të emëruar sipas detyrës zyrtare: Rektori, Sekretari i Kolegjit dhe Udhëheqësi i Zyrës për Sigurim të Cilësisë.

16.8 Komisioni Disiplinor formohet nga Këshilli Akademik për t'i shqyrtuar rastet e sjella para këtij komisioni nga ana e studentëve, stafit dhe menaxhmentit të Kolegjit. Komisioni ka pesë anëtarë të përhershëm të emëruar nga Këshilli Akademik, nga të cilët tre janë përfaqësues të personelit mësimor, një përfaqësues i studentëve dhe një përfaqësues i stafit administrativ.

16.9 Anëtarët e Komisionit Disiplinor duhet të përmbahen nga pjesëmarrja në shqyrtimet e këtij komisioni në rastet kur:

- (a) Personi mbikëqyrës apo vartës i tyre është subjekt i shqyrtimit në Komision Disiplinor;
- (b) Kur me personat, rasti i të cilëve është në shqyrtim kanë lidhje familjare apo miqësore; dhe/ose
- (c) Ka ndonjë konfliktit interesi, siç është specifikuar në Kodin e Mirësjelljes apo aktet tjera normative të Kolegjit.

16.9.1 Rregullat dhe procedurat e punës së Komisionit Disiplinor janë të detajuara në Kodin e Mirësjelljes të Kolegjit dhe në akte tjera normative të Kolegjit. Të njëjtat do të bëhen publike për të gjithë studentët, punonjësit dhe palët tjera me interes për Kolegjin.

16.10 Komisioni për Ankesa shërben si shkallë e dytë për shqyrtim të ankesave ndaj vendimeve të marra nga Komisioni Disiplinor.

16.10.1 Këshilli Akademik emëron pesë anëtarët e Komisionit për Ankesa, nga të cilët tre janë përfaqësues të stafit mësimor, një është përfaqësues i studentëve dhe një është përfaqësues i administratës.

16.10.2 Anëtarët e Komisionit për Ankesa duhet të përmbahen nga pjesëmarrja në shqyrtimet e këtij komisioni në rastet kur:

- (a) Personi mbikëqyrës apo vartës i tyre është subjekt i shqyrtimit para Komisionit për Ankesa;
- (b) Kur me personat, rasti i të cilëve është në shqyrtim kanë lidhje familjare apo miqësore; dhe/ose
- (c) Ka ndonjë konfliktit interesi, siç është specifikuar në Kodin e Mirësjelljes apo aktet tjera normative të Kolegjit.

16.10.3 Rregullat dhe procedurat e punës së Komisionit të Ankesave janë të detajuara në Kodin e Mirësjelljes të Kolegjit dhe në akte tjera normative të Kolegjit. Të njëjtat do të bëhen publike për të gjithë studentët, punonjësit dhe palët tjera me interes për Kolegjin.

## **KAPITALI THEMELOR - AKSIONET**

### **Neni 17**

#### **Rritja dhe zvogëlimi i kapitalit themelor**

Rritja dhe zvogëlimi i kapitalit themelor do të bëhet në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Ligji Nr. 02/L-123 dhe me procedurat e përcaktuara në këtë Statut.

### **Neni 18**

#### **Të drejtat dhe detyrimet në lidhje me aksionet**

18.1 Shoqëria mund të emetojë aksione vetëm në formë të regjistruar;

18.2 E drejta e aksionarëve për lënien peng të aksioneve të shoqërisë nuk mund të kufizohet ose të ndalohet nga shoqëria. Aksionari gëzon të drejtën e votimit të aksioneve të lëna peng, përveç kur parashikohet ndryshe me marrëveshjen e pengut;

18.3 Shoqëria nuk mund t'i lë peng aksionet e veta të paemetuara. Shoqëria mund të marrë peng aksionet e saj vetëm në qoftë se:

- aksionet e lëna peng janë shlyer plotësisht;
- numri total i aksioneve të vetë shoqërisë të lëna peng shoqërisë nuk përfaqëson më shumë se dhjetë për qind (10%) të kapitalit themelor të shoqërisë dhe
- marrëveshja e pengut miratohet nga Bordi Drejtues.

### **Neni 19**

#### **Regjistri i aksionarëve**

19.1. Shoqëria do të krijojë dhe të mbajë një regjistër të aksionarëve. Regjistri do të mbahet në selinë e shoqërisë në Kosovë si dhe tek autoritetet, të cilat do të autorizohen me ligj. Kolegji duhet t'u lejojë aksionarëve, pengmarrësve të aksioneve, apo aksionarëve të emëruar të shohin regjistrin e aksionarëve.

19.2. Të gjitha transferimet e aksioneve regjistrohen në regjistrin e aksionarëve. Në regjistër çdo aksioni duhet t'i korrespondojë një numër rendor. Për çdo numër rendor duhet të regjistrohet emri i aksionarit dhe data e fitimit të aksionit prej tij. Regjistri duhet të përmbajë edhe emrin dhe adresën e aksionarëve që janë persona juridikë ashtu siç janë regjistruar, dhe emrin dhe vendbanimin e aksionarëve që janë persona fizikë. Të dhënat që ka shoqëria për ata që kanë njoftuar shoqërinë se kanë të drejta të siguruara në aksione, duhet të përfshihen në regjistrin e aksionarëve, ku duhet të thuhet nëse ata kanë të drejtën e votës për këto aksione. Regjistri i aksionarëve duhet të përmbajë gjithashtu edhe numrin e aksioneve në pronësi të secilit aksionar. Regjistri i aksionarëve mund të përmbajë edhe të dhëna të tjera.

19.3. Me kërkesën e parë të cilitdo aksionar, të cilitdo përfaqësues të autorizuar të cilitdo aksionar, apo të cilitdo person ose ent që ka interesa të siguruara në aksionet e shoqërisë, mbajtësi i regjistrit të aksioneve duhet të japë të dhëna nga regjistri.

19.4. Regjistrimi i të dhënave në regjistër duhet bërë jo më vonë se tri ditë nga data kur transferuesi ose marrësi i aksionit apo i ndonjë interesi mbi të i dorëzon sekretarit të shoqërisë apo agentit të angazhuar nga shoqëria për mbajtjen e regjistrit të aksionarëve (a) certifikatat e aksioneve që mbajnë nënshkrimin e transferuesit dhe të dhënat që transferuesi ia ka transferuar marrësit aksionet në fjalë; ose (b) në

rastin e aksioneve të pacertifikuara, një deklaratë të bërë nga transferuesi ku ai shpreh se ia ka transferuar marrësit interesin e tij në aksionet e pacertifikuara;

19.5. Nëse Sekretari apo agjenti i shoqërisë nuk regjistron apo refuzon të regjistrojë një të dhënë në regjistrin e aksionarëve, brenda pesë ditëve nga data e kërkesës duhet t'i dërgojë personit që ka kërkuar regjistrimin, shpjegimin për refuzimin e këtij regjistrimi;

19.6. Personi që është i pakënaqur nga refuzimi për regjistrimin e të dhënave në regjistrin e aksionarëve mundet të bëjë një kërkesë në gjykatën përkatëse. Nëse gjykata vendos që regjistrimi duhet të ishte bërë, nëpunësi apo agjenti duhet të bëjë menjëherë regjistrimin. Nëse refuzimi fillestar për të bërë regjistrimin shkakton mospërfshirjen e personit në shpërndarjen e dividendit, shoqëria duhet t'i japë dividendin këtij personi. Nëse refuzimi fillestar shkakton mosparaqitjen e personit në mbledhjen e aksionarëve, në rrethana të përshtatshme gjykata mund të urdhërojë shoqërinë të zhvillojë përsëri mbledhjen. Megjithatë, nga mënyrat e mësipërme nuk mund të përfitojnë palët që i paraqesin sekretarit apo agjentit një certifikatë të aksionit që përmban:

- nënshkrimin e transferuesit që nuk është krejt identik me atë që paraqitet në regjistër; ose
- një nënshkrim i bërë në një gjuhë të paqartë për transferimin.

## **Neni 20**

### **Të drejtat dhe detyrimet e aksionarëve**

20.1. Të drejtat e aksionarëve janë:

- a) të marrë si dividend një pjesë të tepricës, nëse mbledhja e përgjithshme e aksionarëve e deklaron dividendin dhe nëse shoqëria lejohet të paguajë, që në të vërtetë e paguan dividendin;
- b) të marrë shpërndarje proporcionale *pro-rata* të pasurisë neto të shoqërisë kur ajo likuidohet sipas ligjeve dhe rregulloreve mbi falimentimin, pengun dhe paaftësinë për të paguar;
- c) ka të drejtën e parablerjes së aksioneve të emetuara nga shoqëria;
- d) aksionarët mundën t'i lënë trashëgim të gjitha aksionet apo një pjesë të tyre personave fizikë dhe juridikë;
- e) të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e përgjithshme të aksionarëve dhe të votojë në mënyrë të rregullt për çështjet që shtrohen në këto mbledhje, përveç kur parashikohet ndryshe me Statut për sa u përket kategorive të veçanta të aksioneve;
- f) të marrë të gjithë informacionin publik të nxjerrë nga shoqëria në lidhje me veprimtarinë e saj, duke përfshirë të drejtën e marrjes së dëftesave financiare dhe dokumenteve të tjera, siç parashikohet në rregullore dhe në Statutin e shoqërisë.

20.2. Aksionet e të njëjtës kategori kanë të drejta të njëjta. Aksionarët paguajnë për aksionet e tyre në bazë të marrëveshjes në fuqi për nënshkrimin e aksioneve apo dokumenteve të themelimit të shoqërisë.

20.3. Me rastin e shitjes së aksioneve, çdo aksionar ka për obligim që së pari t'ia ofrojë të njëjtat, nën kushte të njëjta të shitjes, aksionarëve të shoqërisë;

20.4. Konfliktet midis aksionarëve, midis aksionarëve dhe shoqërisë, midis aksionarëve dhe nëpunësve e drejtuesve të shoqërisë, do të provohet të zgjidhen me marrëveshje. Nëse kjo nuk mund të arrihet në këtë mënyrë, atëherë kompetente për zgjidhjen e konflikteve do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë.

## **Neni 21**

### **Shpërndarja e fitimeve të shoqërisë**

Shpërndarja e fitimit të shoqërisë bëhet në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare në Republikën e Kosovës.

## **Neni 22** **Kohëzgjatja e shoqërisë**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë, do të jetë pa afat të caktuar.

## **Neni 23** **Likuidimi i shoqërisë**

Likuidimi dhe mbyllja e Kolegjit bëhet në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës. Kompetencën ekskluzive për të vendosur për likuidimin e Shoqërisë e ka Kuvendi i Aksionarëve.

## **Neni 24** **Financimi**

24.1. Kolegji Riinvest do të financohet:

- nga kompensimi për shërbimet e kryera
- nga burimet e brendshme të anëtarëve të saj,
- nga shitja e publikimeve dhe produkteve të tjera të Kolegjit,
- nga grantet që ofrojnë subjektet e tjera publike, shtetërore ose private,
- nga sponsorimet e tjera të ligjshme për organizimin e veprimtarive dhe realizimin e projekteve të caktuara në përputhje me qëllimin e Kolegjit.

24.2 Nuk do të operohet me asnjë lloj financimi tjetër që mund të ofrohet në qoftë se ai del jashtë karakterit dhe bie ndesh me statusin dhe misionin e paracaktuar të Kolegjit.

## **STRUKTURA AKADEMIKE DHE ADMINISTRATIVE E KOLEGJIT**

### **Neni 25** **Struktura organizative e Kolegjit**

25.1 Kolegji përbëhet nga njësitë akademike dhe administrative, për themelimin, konsolidimin dhe mbylljen e së cilave vendosë Bordi Drejtues, në bazë të kritereve të përcaktuara me ligj, këtë Statut dhe aktet tjera normative të Kolegjit.

25.2 Menaxhmenti i Kolegjit përbëhet nga Rektori, prorektorët, Sekretari dhe dekanët e fakulteteve të Kolegjit. Detyrat e prorektorëve, Sekretarit të Kolegjit dhe dekanëve të fakulteteve dhe udhëheqësve të programeve do të rregullohen në mënyrë më të detajuar me rregulloren përkatëse të miratuar nga Bordi i Drejtorëve.

25.3 Punonjësit e Kolegjit ndahen në punonjës akademikë dhe punonjës joakademikë administrativ të nivelit teknik apo udhëheqës. Të gjithë punonjësve të Kolegjit u garantohet e drejta e lirisë së organizimit dhe grumbullimit dhe e drejta e mbrojtjes nga çfarëdo lloji i diskriminimit, në pajtim me ligjet e Kosovës.

25.4 Punësimi në Kolegj do të bëhet në bazë të kontratave të punës apo kontratave për shërbime të posaçme, të cilat do të lidhen në pajtueshmëri me Ligjin e Punës në Kosovë dhe aktet tjera nënligjore të zbatueshme nga fusha e punës.

## **Neni 26** **Organizimi akademik**

26.1 Njësi akademike të Kolegjit Riinvest janë Fakultetet e tij dhe departamentet tjera akademike (në tekstin e mëtejme Fakultetet ose njësitë akademike) të cilat ofrojnë programe akademike baçellor, master ose doktrate me akreditim vendor ose ndërkombëtar, si dhe shërbime tjera të ndërlidhura. Fakultetet e Kolegjit Riinvest udhëhiqen nga dekanët.

26.2 Njësitë akademike krijohen/ mbyllen ose integrohen me vendim të Bordit.

26.3 Parakushtet për hapjen e një njësie akademike janë:

- (a) Ofrimi i një apo më shumë programe të arsimit, kërkimi në kuadër të fushës akademike
- (b) Infrastruktura e mjaftueshme;
- (c) Numri i duhur i personelit akademik që mundëson plotësimin e kërkesave akademike për një periudhë afatgjatë

26.4 Njësia akademike mbyllet nëse:

- (a) Humb akreditimin vendor ose ndërkombëtar,
- (b) Nuk arrin të rekrutojë numër të mjaftueshëm të studentëve,
- (c) Për arsye tjera objektive të konfirmuara nga Bordi i Drejtorëve.

26.5 Fakultetet dhe njësitë akademike tjera janë përgjegjëse për sa vijon:

- (a) T'i propozojë Këshillit Akademik programet e studimeve;
- (b) Të organizojë mësimdhënien, provimet dhe vlerësimet e studentëve;
- (c) Të përcjell progresin akademik të studentëve, duke përfshirë shërbimet akademike të studentëve;
- (d) Të zhvillojë kërkime shkencore sipas standardeve ndërkombëtare;
- (e) Të sigurojë cilësinë, vlerësimin dhe çështjet e raportimit, siç është paraparë me ligj dhe me këtë Statut dhe aktet tjera normative të Kolegjit;
- (f) Të përdorë drejt dhe në mënyrë efikase mjetet, siç është paraparë me ligj dhe me këtë Statut dhe aktet tjera normative të Kolegjit;
- (g) Të menaxhojë çështjet e personelit sipas dispozitave të ligjit, këtij Statuti dhe akteve tjera normative të Kolegjit.

## **Neni 27** **Njësitë akademike të Kolegjit**

27.1 Kolegji ka të organizuara dhe akredituara tri njësi akademike të akredituara nga agjencitë përkatëse të akreditimit:

Departamenti Baçellor Ekonomi me programin:

BA Menaxhim Biznesi

Departamenti Master Ekonomi Ekonomik me programin

MA Menaxhment

Departamenti i Shkencave Kompjuterike, me programin

BSc Shkenca Kompjuterike, Inxhieri Softuerike

Departamenti i Programit të Franshizave

BA (Hons) Menaxhim Biznesi dhe Ndërrmarrësi

BA (Hons) Menaxhim Biznesi dhe Marketing

BA (Hons) Menaxhim Biznesi dhe Burime Njerëzore

MBA Master i Administrimit të Biznesit (i përgjithshëm)

MBA Master i Administrimit të Biznesit (financiar)

27.2 Kolegji ruan të drejtën e organizimit të njësive akademike të reja, me kusht të plotësimit të kushteve të akreditimit. Ndryshimet teknike në emërtimin e programeve në këtë nen nuk do të përbëjnë ndryshim të Statutit dhe mund të kryhen me vendim të Bordit Drejtues.

## **Neni 28** **Komitetet Programore**

28.1 Çdo Njësi Akademike ka Komitetet programore për secilin program që e ofron. Komitetet programore organizohen së paku dy herë në semestër, nën mbikëqyrjen dhe udhëheqjen e drejtpërdrejtë të Dekanit të Fakultetit.

28.2 Komiteti programor përbëhet nga të gjithë mësimmshënësit në program, administrata e programit dhe dy student përfaqësues.

28.3 Komiteti programor i secilit program ka funksionet në vijim:

- Diskuton dhe zhvillon i programet të reja,
- Diskuton dhe zhvillon ndryshimet ne programet ekzistuese,
- Diskuton suksesin e studentëve, aktivitetet e mësimit, aktivitetet shkencore, etj.
- Aprovon syllabuset e reja dhe ndryshimet,
- Propozon projekte kërkimore,
- Cakton komisionet vlerësuese për tema të diplomës/ masterit/ doktoratës.

## **Neni 29** **Stafi akademik**

29.1 Stafi akademik i Kolegjit do të rekrutohet në pajtim me dispozitat e ligjit dhe akteve normative të Kolegjit dhe do të jetë i pavarur në ushtrimin e detyrave të veta.

29.2 Thirrjet e stafit akademik të angazhuar në Kolegj janë: Profesor i Rregullt, Profesor i Asocuar, Profesor Asistent, Asistent, Asistent i Ri. Thirrjet akademike caktohen në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës.

## **Neni 30** **Struktura Administrative e Kolegjit**

30.1 Njësitë administrative të Kolegjit themelohen, shuhën apo integrohen me vendim të Bordit Drejtues sipas nevojës.

30.2 Bordi Drejtues mund të vendosë që njësitë administrative të krijuara me vendim të tij mund të kenë identitet të veçantë administrativ dhe juridik, si dhe të menaxhojnë vet me financat dhe llogaritë



bankare të veta. Njësi e tillë e veçantë është Riinvest Consulting, modalitetet e raportimit të së cilës para Bordit Drejtues do të përcaktohen me vendim të veçantë të tij.

30.3 Njësitë administrative udhëhiqen nga prorektorët apo drejtorët e tyre. Ndryshe nga njësitë tjera administrative, zyra për sigurim e cilësisë gjithashtu monitorohet nga Komisioni për Sigurim të Cilësisë i Këshillit Akademik dhe Rektori i Kolegjit.

### **Neni 31** **Sekretari Përgjithshëm i Kolegjit**

31.1 Sekretari i Përgjithshëm i Kolegjit Riinvest (në këtë Statut i referohet edhe si Sekretari i Kolegjit) është person i autorizuar për çështje administrative dhe nënshkrim në emër të Kolegjit për nevoja të tilla. Sekretari i Kolegjit është person kompetent për përfaqësim të Kolegjit pranë të gjitha ministrive, agjencive dhe institucioneve të Kosovës, si dhe për nënshkrimin e të gjitha dokumenteve administrative që mund të kërkohen nga ministrinë, agjencitë dhe institucionet e ndryshme lidhur me veprimtarinë e Kolegjit.

31.2 Sekretari i Kolegjit është person i autorizuar i Kolegjit për kryerje të veprimtarisë ditore bankare në emër të tij, përfshirë hapjen dhe mirëmbajtjen e llogarive, aplikimin për produkte kreditore (përfshirë, pa kufizime, kreditë, mbitërheqjen, letërgarancionet, letërkreditë, limitin kreditor dhe sistemin e debitimit direkt) pranë të gjitha bankave komerciale në Republikën e Kosovës.

31.3 Sekretari i Kolegjit është përgjegjës për hartimin e kontratave të punës për stafin akademik dhe administrativ të Kolegjit.

31.4 Sekretari i Kolegjit është përgjegjës për hartimin e vendimeve, shkresave dhe akteve tjera të cilat i nxjerrin organet e Kolegjit nga fushëveprimtaria e tyre përkatëse, si dhe për mbajtjen e dosjeve, dokumentacionit dhe procesverbaleve të Kuvendit të Aksionarëve dhe Bordit Drejtues.

31.5 Sekretari i Kolegjit udhëheq procedurat administrative të Kolegjit dhe harton shpalljet publike të tij.

## **STUDENTËT DHE ORGANIZIMI STUDENTOR**

### **Neni 32** **Studentët**

32.1 Studentët pranohen në programet e Kolegjit në bazë të konkurrencës dhe meritës.

32.2 Studentët që janë pranuar dhe regjistruar në Kolegjin Riinvest hyjnë në marrëdhënie ligjore me të, përmes nënshkrimit të marrëveshjes përkatëse. Me rastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, studentëve u bëhen me dije aktet normative të Kolegjit dhe kodet e etikës dhe mirësjelljes të cilave duhet t'u përmbahen gjatë studimeve.

32.3 Studentët kanë të drejtat dhe përgjegjësitë në vijim:

- a. të ndjekin të gjitha ligjëratat, seminarët dhe aktivitetet e tjera mësimore;
- b. të përdorin ambientet në biblioteka dhe shërbimet e tjera për studentë;

- c. të zbatojnë rregullat e hartuara nga institucioni;
- d. të kushtojnë vëmendje të duhur e të plotë studimeve dhe të marrin pjesë në aktivitetet akademike.

32.4 Studentët kanë të drejtë të ankohen lidhur me cilësinë e procesit të mësimdhënies ose infrastrukturës së Kolegjit, ndërsa ankesat në fjalë do të trajtohen nga Rektori i Kolegjit në bazë të akteve normative të Kolegjit.

### **Përfaqësimi i studentëve dhe Unioni i studentëve**

#### **Neni 33**

33.1 Studentët janë të përfaqësuar në të gjitha njësitë akademike të Kolegjit. Në Këshillin Akademik marrin pjesë pesë studentë të zgjedhur nga kolegët e tyre. Këta zgjedhen nga drejtimet e tyre dhe nuk do të thotë që të gjithë janë anëtarë të Kryesisë së Unionit. Nga pesë studentët anëtarë të Këshillit Akademik, dy janë nga programet bachelor shqip, një nga programet master shqip, një nga programet baçellor anglisht dhe një nga programet MBA anglisht. Një student merr pjesë në komisionin për sigurim të cilësisë, një student në komisionin disiplinor dhe një student në komisionin për ankesa. Në secilin komitet programor do të marrin pjesë nga dy studentë.

33.2 Studentët e kanë të drejtën e organizimit të vet në Union studentor brenda Kolegjit. Unioni i studentëve e rregullon veprimtarinë e vet me rregullore të veçantë.

### **ORGANIZIMI I STUDIMEVE**

#### **Neni 34**

#### **Titujt, Diplomat dhe programet e studimeve**

34.1 Kolegji Riinvest ofron tituj dhe diploma te programeve te akredituara ne Kosovë apo jashtë saj sipas ligjit ne fuqi. Sipas veprimtarisë dhe në bazë të certifikatës së akreditimit të vet, Kolegji Riinvest ofron këto tituj:

1. BA – Bachelor të Arteve
2. BSc – Bachelor të shkencave
3. MA – Master të Arteve
4. MSc – Master të shkencave
5. PhD- Doktor i Filozofisë

34.2 Nivelet e programeve rregullohen me rregullore te studimeve të nivelit baçellor ( BA dhe BSc) dhe të studimeve pasdiplomike (MA/MSc dhe PHD). Rregulloret aprovohen nga Këshilli Akademik në bazë të një procesi konsultimesh paraprake me të gjithë akterët.

34.3 Në rast të ofrimit të programeve franshize, diplomat lëshohen nga Universiteti i Autorizuar sipas rregulloreve të aprovuara në procesin e validimit.

34.4 Studimet bazë (bachellor) zgjasin tri vjet dhe sigurojnë 180 ECTS. Studimet master zgjasin një deri në dy vjet dhe sigurojnë 60. 90 ose 120 ECTS, kurse studimet e doktoratës zgjasin 3 vjet dhe sigurojnë 180 ECTS.

34.5 Kolegji mund të ofrojë edhe programe të certifikuara nga agjencitë tjera profesionale dhe akademike në kuadër të shërbimeve të ofruara nga njësitë tjera organizative të veta. Kolegji mund të themelojë njësi të reja për të ofruar studime dhe certifikim në fusha të caktuara si zhvillimi ekonomik lokal, zhvillimi biznesor, përdorim i softuereve, shkathtësi gjuhësore, etj. Këto programe do të certifikohen nga institucionet përkatëse.

### **Neni 35** **Llojet e studimeve**

35.1 Kolegji Riinvest ofron këto lloj studimesh:

- Studime të rregullta,
- Studime me korrespondencë,
- Studime nga distanca.

35.2 Mënyra e studimeve përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi ose në përputhje me kushtet e aprovuara në franshizë. Në informatën për programin specifikohet saktë mënyra e studimeve dhe kohëzgjatja e studimeve.

35.3 Studimet e rregullta përfshijnë organizimin e studimeve me ngarkesën e rregullt të caktuar brenda viteve të studimeve për ciklin e caktuar.

35.4 Studimet me korrespondencë përfshijnë organizimin e studimeve me formën dhe orarin e përshtatur për studentët e regjistruar me korrespondencë. Kjo mund të përfshijë organizimin e moduleve bllok dhe zgjatjen e kohës së studimeve për të përshtatur ngarkesën e studimeve.

35.5 Studimet në distancë përfshijnë organizimin e studimeve tërësisht online apo të përzier. Sipas programit të akredituar, Kolegji organizon ligjëratat, ushtrimet, materialet dhe vlerësimin në gjuhën në të cilën ofrohet programi në platformën online. Koncepti didaktik aprovohet në komitetin programor dhe këshillin akademik.

### **Neni 36** **Vlerësimi i suksesit**

36.1. Për përcaktimin e suksesit akademik do të aplikohen këto metoda:

- (a) Provimi
- (b) Kolokviumi
- (c) Punimet seminarike
- (d) Testi praktik gjatë ushtrimeve
- (e) Interpretimi dhe prezantimi i rezultateve

36.2 Kolegji do t'i përdorë këto nota për të përshkruar nivelin e suksesit të studentëve:

Riinvest Nota	ECTS Nota	Përqindja	Përkufizimi
Riinvest Mark	ECTS Mark	Percentage	Definition

(4)	(5)	(6)	
10	A	90-100	SHKËLQYESHËM/EXCELLENT
9	B	80-89	SHUMË MIRË/VERY GOOD
8	C	70-79	MIRË/GOOD
7	D	60-69	KËNAQSHËM /SATISFACTORY
6	E	50-59	MJAFTUESHËM/PASS
5	FX/F	0-49	DOBËT/ FAIL

36.3 Provimet shërbejnë si mënyra të rregullta të vlerësimit të dijes së studentëve, ato do të organizohen me shkrim, me gojë, me punë praktike ose në mënyrë të kombinuar. Për afatet e provimeve vendos Këshilli Akademik.

### **Neni 37 Viti akademik**

Viti akademik fillon më 1 tetor dhe mbaron më 30 shtator. Periudha e studimeve është e ndarë në dy semestra. Semestri dimëror fillon më 1 tetor dhe mbaron më 15 janar. Semestri veror fillon më 25 shkurt dhe mbaron më 31 maj. Orari i studimeve përgatitet për tërë vitin nga udhëheqësit e departamenteve.

### **Neni 38 Punimi i diplomës**

38.1 Kolegji njih dy lloje të punimeve të diplomave: për programin bachelor dhe për programin master.

38.2 Në nivelin bachelor, tema e diplomës merret në vitin e tretë. Udhëheqësi i programit i cakton mbikëqyrësin studentit në bazë të temës. Komiteti programor, përcakton komisionet për kandidatët. Me temën e diplomës studenti edhe diplomon. Prezantimit i temave të diplomës bëhet para komunitetit të studentëve, stafit akademik dhe përfaqësuesve të komunitetit të biznesit dhe ka për qëllim edhe promovimin e të diplomuarëve tek punëdhënësit potencial.

38.3 Për nivelin master, Komiteti programor formon juri profesionale (3-5 anëtarë) për vlerësimin e temës, i cila duhet të bëjë një raport brenda tri javësh për Komisionin akademik. Komisioni Akademik deri më 20 janar (pra deri në përfundim të semestrit III) aprovon raportin dhe cakton mbikëqyrësin. Studenti fillon konsultimet me mentorin e tij pas përfundimit të provimeve. Gjatë semestrit IV, studenti zhvillon projektin e tij kërkimor dhe hartimin e provimit të masterit.

### **Neni 39 Emërtimi i dokumenteve që Kolegji do t'ua lëshojë studentëve**

Studentëve që do t'i mbarojnë studimet në këtë Kolegjin Riinvest, do t'u lëshohen këto dokumente:

- Diplomë mbi fitimin e titullit akademik të BSC Inxhinieri Softuerike
- Diplomë mbi fitimin e titullit akademik të BA Menaxhim Biznesi;
- Diplomë mbi fitimin e titullit akademik MA Menaxhment;
- Diplomë mbi fitimin e titullit akademik MSc në Inxhinieri Softuerike;
- Diplomë BA (Lëshohet nga Staffordshire University-UK);
- Diplomë MBA (Lëshohet nga Staffordshire University-UK).
- Diplomë mbi fitimin e titullit akademik PhD në Ekonomi

Diploma përfshin edhe emërtimin e profileve dhe duhet të jetë në përputhje të plotë me emërtimin e akredituar

**Neni 40**  
**Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

40.1 Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti, shfuqizohen të gjitha versionet paraprake të Statuteve të Shoqërisë.

40.2 Bordi Drejtues, i zgjedhur sipas këtij Statuti, dhe organet tjera menaxhuese të Shoqërisë obligohen që të gjitha aktet tjera normative të Kolegjit t'i sjellin në pajtueshmëri me këtë Statut, brenda tre muajsh nga hyrja e tij në fuqi.

Prishtinë  
16 nëntor 2017

**Kryetari i Kuvendit të Aksionarëve,**

---

Rasim Mrlaku